



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.614/6 prot.

Datë 10.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 371/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Pisha” SHPK me NIPT K12526207V dhe adresë: Rruga Labinot Fushe-Elbasan km 1, zk.2355, pasuria nr.A, Elbasan.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.  
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, me NIPT K01529003M, dhe adresë Rruga Muhamet Gjollesha 71/3, Kati 1, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përgendruara sh.a.

II.2. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05.01.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

PISHA	29,927,232 lekë	Kualifikuar
SULLOLLARI-KLIMA	15,995,888.64 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 08.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 12.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6246 dhe me nr. protokollit 73/2026, datë 12.01.2026, e operatorit ekonomik “Sullollari-Klima” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 73/1, datë 12.01.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/2 prot., datë 21.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sullollari-Klima” SHPK. Referuar vendimit të KSHA

rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/3 prot., datë 23.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

II.9. Në datë 27.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.147/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..” [...]

II.10. Në zbatim të vendimit Nr.147/2026, datë 27.01.2026 të KPP, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 30.01.2026, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

PISHA	29,927,232 lekë	Kualifikuar
SULLOLLARI-KLIMA	15,995,888.64 lekë	Kualifikuar

II.11. Në datën 17.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt – ankimi

II.12..Në datën 26.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6367 dhe me nr. protokoll 6142026, datë 26.02.2026, e operatorit ekonomik “Pisha” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 614/1, datë 27.02.2026.

II.14.Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, në datën 02.03.2026 operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar ka parqitur formularin e argumentave, protokolluar me tonën me nr.614/2 prot., datë 03.03.2026.

II.15 Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/32 prot., datë 06.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 614/3 prot., datë 09.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 39/2026 prot., datë 06.03.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Pisha” SHPK, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pisha” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Në datën 17.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt:

“LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

III.1.2. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05.01.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

PISHA	29,927,232 lekë	Kualifikuar
SULLOLLARI-KLIMA	15,995,888.64 lekë	Skualifikuar

III.1.4. Në datën 08.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.5. Në datën 12.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6246 dhe me nr. protokoll 73/2026, datë 12.01.2026, e operatorit ekonomik “Sullollari-Klima” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 73/1, datë 12.01.2026.

III.1.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/2 prot., datë 21.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sullollari-Klima” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/3 prot., datë 23.01.2026, ka përcjellë pranë

Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

III.1.9. Në datë 27.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.147/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..” [...]

III.1.10 Në zbatim të vendimit Nr.147/2026, datë 27.01.2026 të KPP, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 30.01.2026, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

PISHA	29,927,232 lekë	Kualifikuar
SULLOLLARI-KLIMA	15,995,888.64 lekë	Kualifikuar

III.1.11. Në datën 17.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.1.12..Në datën 26.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6367 dhe me nr. protokollit 6142026, datë 26.02.2026, e operatorit ekonomik “Pisha” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të

Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.13. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 614/1, datë 27.02.2026.

III.1.14. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, në datën 02.03.2026 operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar ka parqitur formularin e argumentave, protokolluar me tonën me nr.614/2 prot., datë 03.03.2026.

III.1.15. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/32 prot., datë 06.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 614/3 prot., datë 09.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 39/2026 prot., datë 06.03.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Pisha” SHPK, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.16. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i prokurimit Publik*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.*”.

III.1.17. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.I.18. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1.Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.I.19. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.I.20. Në nenin 94 pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Ndërsa, në nenin 97 pika 2 dhe 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

2.Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5.Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

Neni 51 i Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se:

Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a. juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b. legjitimitimin e ankuesit;

c. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d. elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregulloreje.

II.I.21. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se autoriteti kontraktor në datë 05.01.2025 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK rezulton i skualifikuar. Gjithashtu, në datë 08.01.2026, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në datën 12.01.2026, operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij. Në datë 27.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.147/2026, ku ndër të tjera vendosi:1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e

*kualifikuar atë. Në datën 30.01.2026, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në zbatim të vendimit Nr.147/2026, datë 27.01.2026 të KPP, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK. Në datën 26.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Pisha” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. KPP vlerëson se operatori ekonomik “Pisha” SHPK, si operator i cili mund të çënohej nga ankesa e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ka pasur në dispozicion afatet e tij procedurale për të paraqitur ankesë lidhur me lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK nga procedura e prokurimit objekt ankimi, afate të cilat kanë filluar nga e nesërmja e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (nga e nesërmja e datës 08.01.2026), pra nga data 09.01.2026 deri në datën 19.01.2026. Neni 97, pika 2 dhe 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon se: *2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar. 5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.* Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar (siç është procedura e prokurimit objekt ankimi), në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. duke mos përfshirë ditën e publikimit të njoftimeve përkatëse. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak 08.01.2026 (nga e nesërmja e datës 08.01.2026), pra nga data 09.01.2026, ka qenë data 19.01.2026. Ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik e depozituar në sistemin e ankesave elektronike nga operatori ekonomik, “Pisha” SHPK, është paraqitur në datën 26.02.2026, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar në sistemin e ankesave elektronike jo më vonë se në datën 19.01.2026, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për

përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Në nenin 118, pika 2, germa “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”*

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pisha” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pisha” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

